



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr. 806/09

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN gjyqtarja Shpresa Emra, në çështjen civile të paditëseve Sh. G. dhe Sh. G.1 , që të dyja nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson N. Ç. av. nga Prizreni, kundër të paditurit B. D. nga fsh. K. KK Prizren, për kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me dt.14.10.2013 muar këtë,

A K T G J Y K I M

I PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëseve Sh. G. dhe Sh. G.1 që të dyja nga Prizreni, si e bazuar,

II. OBLIGOHET i padituri B. D. , nga fsh. K. , KK Prizren që paditëseve në emër të kompensimit për dëmin e shkaktuar për lëndimet trupore dhe dëmit jomaterial ti paguaj, më sa vijon :

- Për paditësen Sh. G.:

- a) Në emër të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësor prej 15% shumën prej 3000€
- b) Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000€
- c) Në emër të frikës së pësuar shumën prej 1.000€
- d) Në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1.000€

Në shumë të përgjithshme prej 6.000€

-Për paditësen Sh. G.1 :

- a) Në emër të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 10% shumën prej 2000€
- b) Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1000€
- c) Në emër të frikës shumën prej 1.000€

Në shumë të përgjithshme prej 4.000 €

Të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadsisë mbi pjesën e aprovuar, nga pjesa e kërkuar REFUZOHET SI E PABAZUAR.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditëset, respektivisht i autorizuari i tyre, në padi dhe në shqyrtim kryesor kanë cekur se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur me dt. 23.11.1999 në rrugën magjistrale Prizren–Suharekë me rastin e përplasjes së dy kamionave, njërin prej të cilit ishte duke e vozitur i padituri në këtë rast, kanë marë lëndime të rënda trupore paditëset Sh. dhe Sh.1 G. . I padituri me aktgjykim P.nr.155/01 të Gjykatës Komunale në Prizren është shpallur fajtor dhe është gjykuar me 8 muaj burgim me kusht në afat prej 2 viteve. Sipas kërkespadsisë së precizuar Sh. G. 1 i është zvogluar aktiviteti jetësor për 15% si dhe ka përjetuar frikë të intenzitetit të lartë dhe të mesëm dhe dhimbje të intenzitetit të ndryshëm gjithashtu ka pësuar edhe thyerje të klavikulës për të cilën edhe ka pasur nevojë për ndihmën e personit tjetër për dy muaj dhe ushqim të përforcuar. E gjithë kjo ka shkaktuar edhe shëmtim trupor të shkallës së mesme. Derisa Sh. G. poashtu ka pësuar thyerje të ashtit të nofullës së poshtme të fytyrës të cilat lëndime konsiderohen si lëndime të rënda trupore me invaliditet prej 10% të zvoglimit të aktivitetit jetësor me ç’ rast edhe ka pasur edhe dhimbje fizike si dhe ka përjetuar frikë. Shëmtim trupor ka pasur në kuptim të kufizimit të lëvizjes së gojës së shkallës së lehtë dhe ka pasur nevojë për ndihmën e personit të huaj dhe ushqim të përforcuar dy muaj. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i paditëseve ka propozuar që gjykata të aprovoj kërkesë padinë në tërësi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin që të paguaj në emër të dëmit jomaterial paditëseve dhe atë për paditësen Sh. G.1 shumën prej 10.000€ kurse për Sh. G. 5.000€ për të gjitha elementet e dëmit jomaterial duke filluar nga zvoglimi aktivitetit jetësor, dhimbjes, frikës, shëmtimit, ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të huaj të gjitha duke llogaritur me kamatë ligjore që nga dita e parashtrimit të padsisë në gjykatë. Gjithashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale dhe atë 7 seanca të mbajtura me nga 12€ në lartësi prej 840€, në emër të ekspertizës mjekoligjore të ekspertëve psikiatër dhe neurokirurg shumën prej 300€, në emër të përpilimit të padsisë ëshumën prej 100€ gjithësejt në shumë prej 1240€.

I padituri në shqyrimin kryesor ka deklaruar se nuk e konteston bazën juridike të padsisë por e konteston lartësimin e saj. Ka deklaruar se ai ka tentuar që disa herë të arrihet marrëveshja sipas zakoneve, por kjo nuk është realizuar. Është i gatshëm që të paguaj kompensim gjerë më 3.000€ dhe atë me këste pasi që i njëjti nuk ka mundësi që menjëherë të paguaj shumën e kërkuar. Në fjalën e tij të fundit ai ka deklaruar se shumatat e kërkuara nga paditëset janë të larta dhe nuk ka mundësi që të njëjtën të

paguaj pasi që vetëm ai punon dhe me një rrogë e mbanë familjen gjashtë anëtarsh. Nëse do të kishte pasur mundësi do të kishte paguar edhe dyfishin por nuk ka mundësi. Shumën e ofruar më lart është i gatshëm që të paguaj por më shumë nuk ka mundësi. Ia ka lënë gjykatës që të vendos në këtë çështje dhe ka cekur se nëse duhet ai kompensimin do të paguante me burg. Nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Vlerësimi provave

Janë administruar provat: me leximin e aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës komunale në Prizren P.nr.155/01, me shiqimin në fletëlëshimin nga spitali me nr.7022 dhe numri i protokollit 448/99, është ndëgjuar dhe lexuar mendimi i ekspertit mjekoligjor C. M. të dt. 14.03.2007, janë ndëgjuar ekspertit Dr. B. E. Neurokirurg nga Prishtina dhe Dr. N. F. – psikiatër nga Prizreni në shqyrtim me dt. 19.08.2013.

Gjykata pas vlerësimit të çdo prove të administruar veç e veç dhe të gjitha së bashkë dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, në kuptim të nenit 8 të LPC ka gjetur se,

Kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e bazuar.

Me leximin e aktgjykimit të plotëfuqishëm të Gjykatës komunale në Prizren P.nr.155/01 të dt. 07.05.2001 është vërtetuar se ië akuzuari B. D. , nga fsh. K. , KK Prizren është shpallur fajtor për veprën penale kundër sigurisë në komunikacion nga neni 171 al.4 të lidhur me nenin 165 al3 të LPK dhe i njejtë është gjykuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 vitesh. B.D. është dënuar për aksidentin e shkaktuar në rrugën magjistrale Suharekë Prizren me rastin e ngasjes së kamionit të tij ka shkaktuar aksident dhe e ka goditur kamionin tjetër ku me atë rast ka ardhur gjer te shkapërderdhja e pjesëve të kamionit ku janë goditur të dëmtuaret Sh.1 dhe Sh. G. të cilat kanë marrë lëndime të rënda trupore.

Me shiqimin në fletëlëshimin nga spitali nr.448/99 të dt. 03.12.199 për Sh.G. është vërtetuar se e njejtë është e lindur në vitin 1981 dhe është pranuar në spital me dt. 23.11.1999 dhe është lëshuar me dt. 03.12.1999 . Është pranuar në klinikë për shkak të lëndimeve të shkaktuara në fytyrë nga aksidenti i komunikacionit , është e nënshkruar nga ana e shefit të klinikës Derisa me shiqimin në fletëlëshimin me nr. 7022 për Sh. G.1 është vërtetuar se e njejtë është pranuar në shërim me dt. 29.11.1999 dhe është shëruar gjer më dt. 02.12.1999 . Është pranuar në shërbimin e emergjencës pas një traume të kokës nga aksidenti i trafikut .Më pas është vendosur në repartin e neurokirurgjisë ku ka qëndruar gjer më lëshimin e saj . Fletëlëshimi është nënshkruar nga ana e dy neurohirurgëve të spitalit.

Me leximin e mendimit të ekspertit mjekoligjor C. M. të dt. 14.03.2007 dhe me ndëgjimin e tij në shqyrtim me dt. 06.06.2007 është vërtetuar se paditësja Sh. G.1 në aksidentin e ndodhur me dt.23.11.1999 ka pësuar lëndime të rënda trupore të përshkruara si thyerje të kockave të anës së djathtë të mëthore të paritit të kokës të mbështjellësit trunorë të përcjellur me pasqyrën klinike e objektive si përgjumje,

pengesa në të folur , paralizën në anën e djathtë të cilat kanë detyruar tretman kirurgjik . Gjithashtu e ka lënduar anën e majtë të mbisupit që klasifikohet si thyerje e klavikulës e cila kualifikohet si lëndim i rëndë trupor. Sipas këtyre lëndimeve elementi mjekoligjor përcakton uljen e aftësisë jetësore në masë prej 20 %. Paditësja ka përjetuar dhimbje trupore të intenzitetit posaçërisht të rëndë, të intenzitetit të rëndë dhe të mesëm si dhe dhimbjet herë pas here janë të pranishëm, si dhe ka përjetuar frikë të intenzitetit të lartë dhe të ulët ende të pranishëm.Për paditësen Sh. G. eksperti mjekoligjor ka cekur se e njehta në aksidentin e lartëcekur ka pësuar lëndime të rënda trupore të kualifikuara si plagë shqyese-pëlçitëse në fytyrë të shoqëruara me gërvishje sipërfaqësore të përcjellura me thyerje complete, fragmentare të hapur dhe dislokim të elementeve të kockave të thyra në nofullën e poshtme të shkaktuara nga dinamika e goditjes së pjesëve të automjetit.Sipas lëndimeve të dhëna të njejtës i është zvogëluar aktiviteti jetësor për 15%, ka përjetuar dhimbje trupore të intenzitetit posaçërisht të rëndë, të rëndë, të mesëm dhe herë pas here ende të pranishme si dhe ka pësuar frikë të intenzitetit të lartë dhe të ultë ende të pranishme.

Me shiqimin në raportet e tjera mjekësore është vërtetuar se Sh. G.1 është mjekuar në Klinikën Radiologjike Rezonanca si dhe është vizituar te mjeku neurokirurgu Dr. B. K., kurse Sh. G. për barëra në barnatoren D. ka paguar shumën e të hollave prej 371.65 €.

Me dëgjimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. B. E. neurokirurg nga Prishtina gjykata ka vërtetuar se Sh. G.1 ka pasur thyerje të kafkës së kokës me një presion të fragmentit kockor në brendi të cipës së trurit si dhe një hematom (gjakderdhje lokale) në vendin e lëndimit. Te pacientja është realizuar intervenimi neurokirurgjikal në ditën e pranimit dhe është bërë largimi i ashtit të zhytur apo të thyer si dhe evakuimi i hematomit. Kjo karakterizohet si lëndim i rëndë trupor dhe si rrjedhojë ka zvoglim të aktivitetit jetësor prej 15% e njehta ka pësuar dhe ka përjetuar dhimbje fizike posaçërisht të rënda 4 orë, të rënda ka pasur 4 ditë , të intensitetit të mesëm 30 ditë kurse të intensitetit të ultë mund të ketë edhe sot.Gjithashtu ka pasur edhe thyerje të klavikulës e cila është mobilizuar por e cila nuk ka lënë pasoja të mëtejshme.Ka pasur nevojë për ndihmën e personit të huaj për 2 muaj dhe për ushqim të përforcuar në afat prej 2 muajve si dhe shëmtim trupor të shkallës së mesme.

Sh. G. ka pësuar thyerje të ashtit të nofullës së poshtme të fytyrës ku edhe është realizuar intervenim kirurgjik në ditën e pranimit për stabilizimin e fragmenteve të dislokuara të nofullës të cilat konsiderohen si lëndime të rënda trupore dhe kufizimi i hapjes së nofullës gjegjësisht të dhëmbëve sjell edhe shkallën e invaliditetit prej 10% të zvoglimit të aktivitetit jetësor.Ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që nga momenti i aksidentit gjerë më dhënien e ndihmës së parë në kohëzgjataje prej 4 orëve, të intensitetit të rëndë ka pasur 4 ditë, të intensitetit të mesëm 30 ditë si dhe të intensitetit të ultë mund të ketë edhe sot e kësaj dite. Ka shëmtim trupor të shkallës së lehtë e cila ka të bëjë me kufizimin e lëvizjes së gojës ku ka pas nevojë edhe për ushqim të përforcuar për 2 muaj dhe 2 muaj për ndihmën e personit të tretë.

Me dëgjimin e ekspertit mjeko ligjor psikiatër Dr. N. F. gjykata ka vërtetuar se Sh. G.1 në aksidentin e komunikacionit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe me këtë rast ka pasur një nivel të frikës sekondare që ka zgjatur për 2 ditë e cila është manifestuar me brengosje për pasoja të aksidentit për aftësinë e mëtejshme jetësore si dhe kujtimet në lidhje me aksidentin. Ka patur frikë të intensitetit të mesëm 2 muaj dhe në vazhdim të intensitetit më të ultë të frikës që ka zgjatur një vit dhe se ka pasur pasoja nga tronditja të cilat manifestohen me kokëdhimbje të kohë pas kohshme dhe një dozë të caktuar të stresit. Sh. G. ka pësuar gjithashtu lëndim të rëndë trupor dhe ka përjetuar frikë primare 2 minuta, frikë të intensitetit të lartë sekondar 2 orë, të intensitetit të mesëm 4 javë gjatë së cilës kohë ka pasur momente të shpërthimit të traumës së pësuar nga aksidenti dhe frikë të nivelit të ultë sekondar në kohëzgjatje prej 1 viti e cila manifestohet në formë të ndieshmërisë së shtuar dhe ripërjetimeve stresogjene nga trauma e pësuar.

Vlerësimi juridik

Në bazë të të dhënave jo kontestuese në mes të palëve, provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, gjykata ka konstatuar se ka ndodhur aksidenti ku paditëset Sh.1 dhe Sh. G. kanë pësuar lëndime të rënda të ndryshme trupore. Gjithashtu nuk është kontestuese se përgjegjës për këtë aksident është shpallur i padituri gjë që është vërtetuar me aktgjykimin penal të plotëfuqishëm të kësaj gjykate si dhe i padituri në shqyrtimin kryesor dhe fjalën e fuëndit e ka pranuar fajin se ai është përgjegjës për aksident dhe shkaktimin e dëmit jomaterial respektivisht të lëndimeve të cilat i kanë pësuar paditëset. I padituri është përgjegjëse në bazë të përgjegjësisë në rast të aksidentit të shkaktuar nga automjeti në lëvizje në kuptim të nenit 159 LMD, për shpërblim të dëmit në rast të lëndimit neni 179 LMD, shpërblim të dëmit material dhe jomaterial në të holla neni 173 dhe 183 LMD për sigurimet e detyruara për dëmin material të shkaktuar e të paraparë sipas parimit të përgjegjësisë objektive dhe përgjegjësisë së kontraktuar sipas polisës së sigimit për dëmin ndaj personave të tretë në kuptim të nenit 922,923 dhe 924 të LMD. Pra nga vet fakti që baza juridike nuk është kontestuese, por lartësia e kompensimit është kontestuar dhe të njëjtën gjykata e ka përcaktuar kryesisht në bazë të mendimit të ekspertve mjeko ligjor dhe të vlerësimit të lirë ku mendimi i ekspertve është vlerësuar si gjithpërfshirës dhe real bazuar në dëmin jomaterial të pësuar dhe i caktuar sipas intensitetit lartësisë, zgjatjen e dhimbjeve të frikës .

Kompensimi i dëmit jomaterial dhe material në të holla ka për qëllim satisfakcionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi(nuk mund të komercializohen vlerat morale). Lartësinë e dëmit gjykata ka vlerësuar sipas vlerësimit të mjekut ekspert neurokirurg dhe psihijatër si dhe vlerësimit të lirë të gjykatës në kuptim të nenit 183 LMD dhe 47 LPK .

Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën tjetër të saj, për shkak se gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit duke pasur parasysh lëndimet e marra dhe qëllimi për të cilën ky kompensim dedikohet ka ardhur në konkludim se vlerat e kërkuara nga ana e të autorizuarit të paditësit si dhe oferta e dhënë nga ana e të autorizuarit të paditurës nuk janë reale, pasi që njëra është tepër e lartë dhe tjetra tepër

e ultë. Andaj, vlerësimin e ka bërë në bazë të bindjes së lirë dhe vlerësimit të gjithmbarshëm të gjendjes faktike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr në kuptim të nenit 452.2 të LPK, pasi që paditëset pjesërisht e kanë realizuar kërkesën gjykata ka vendosur që në përputhje me suksesin e aritur të kompensohen edhe shpenzimet procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.806/09 me dt.14.10.2013

Gjyqtarja
Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.